



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА  
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë " Nr. 12/2019) neni 40 paragrafi 2 nga Rregullorja për punë të Komisionit Shtetërorë për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar sipas denoncimit të parashtruar nga parashtruesi i njohur KSHPK-ja (në tekstin e mëtejshëm) në seancën së 87-të, të mbajtur më 01.06.2023, morri vendimin vijues:

## VENDIM

Procedura sipas lëndës me numër 12-7366/1 të datës 26.07.2022, është formuar sipas denoncimit me pretendime për mosdhënie leje ndërtimi, **HIDHET POSHT**

KSHPK-ja vërtetoi se në pajtim me Ligjin për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave nuk ka elemente për veprim të mëtutjeshëm sipas lëndës për arsye se ka vepruar dhe ka ndërmarrë masa organi kompetent shtetërorë.

Lënda me numër 12-7366/1 të datës 26.07.2022 të mbyllet dhe të arkivohet.

Vendimi i KSHPK-së, me arsyetim - në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

## Arsyetim

Nga një parashtruesi i njohur më 26.07.2022 ka dorëzuar denoncim me pretendime për mos dhënie e lejes për ndërtim dhe është formuar lënda me numër 12-7366/1 të datës 26.07.2022.

Në denoncim parashtruesi shprehet se nuk mund të marrë leje për ndërtimin e një muri mbajtës në parcelën e tij. Sipas pretendimeve në denoncim, parashtruesi ka dorëzuar kërkesë për leje rrethimi në tokën PK-së ----- KK ----- më 25.11.2022, pastaj më 25.11.2022. 13.01.2022 kërkesë për ndërtimin e murit mbajtës mbrojtës në të njëjtën parcelë dhe më datë 28.01.2022 nëpërmjet sistemit elektronik të miratimit të ndërtesës me nr. UP1 ----- është paraqitur kërkesa për marrjen e vendimit për ndërtimin e murit mbajtës në parcelën në fjalë.

Me qëllim verifikimin e pretendimeve dhe konstatimin e gjendjes faktike në rastin e denoncuar, KSHPK-ja ka paraqitur kërkesë për mbikëqyrje të jashtëzakonshme inspektuese në Inspektoratin administrativ shtetërorë.

Inspektorati Shtetëror Administrativ ka dërguar njoftim se është ndërmarrë iniciativë për kryerjen e inspektimit të jashtëzakonshëm në lidhje me pretendimet nga denoncimi. Njëkohësisht nuk janë konstatuar mangësi, përkatësisht procedura është zhvilluar sipas sistemit elektronik të miratimit elektronik dhe procedura e inspektimit është ndërprerë nga inspektori administrativ me udhëzim për kompletimin e lëndës. Gjithashtu, raportohet se pas mbikëqyrjes është dërguar njoftim nga Komuna----- se është marrë vendim përmes sistemit elektronik të lejeve të ndërtimit, duke refuzuar kërkesën e investitorit dhe e njëjta është i formës së prerë.

Nga të gjitha konstatimet e lartpërmendura, KSHPK-ja konstatoi se nuk ka elemente për veprime të mëtutjeshme lidhur me rastin sepse organi kompetent ka vepruar dhe ka marrë masa për rastin në fjalë, prandaj edhe ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Dorëzuar:  
- Parashtruesi i denoncimit

Përgatiti: B.K.SH  
Miratoi: S.P.D anëtar i KSHPK-së

КОМИСИОНИ СХТЕТЉРОР  
ПЉР ПАРАНДАЛИМИН Е КОРРУПСИОНИТ

Nënkryetar,  
Katica Nikolovska

